

PARTIA DEMOKRATIKE
DEGA PATOS

Patos, më 17 /03/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: Partia Demokratike Dega Patos

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale , Neni 328 "Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve" dhe 329 "Kanosja e zgjedhësit".

KUNDER: [REDAKTUAR] me detyrë [REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]

DREJTUAR: Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 të K.Pr.Penale, si dhe neneve 328 dhe 329 të Kodit Penal, parashtrajmë këtë kallëzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Çdo person që ka marrë dijani për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

1.2. Nga ana tjetër Kodi Penal në dispozitat e tij parashikon se: